



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 577/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Marrëveshje kuadër”, me Nr.REF-82421-08-08-2018, me objekt: “*Sherbimi me roje private SH.P.S.F*”, me fond limit 8.163.448,96 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.09.2018 nga autoriteti kontraktor S.U.O.GJ “Mbreteresha Geraldine”.

Ankimues:

“Snajper Security” sh.p.k
Lagja “Pjetër Budi”, Rr. “Kont Uran”, ngjitur me Gjykatën Mat,
Mat

Autoriteti Kontraktor:

S.U.O.GJ “Mbreteresha Geraldine”,
Blv. Zog i I-re, Tirane,

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.08.2018 është publikuar në SPE procedura e prokurimit “Marrëveshje kuadër”, me Nr.REF-82421-08-08-2018, me objekt: “*Sherbimi me roje private SH.P.S.F*”, me fond limit limit 8.163.448,96 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.09.2018 nga autoriteti kontraktor S.U.O.GJ “Mbretresha Geraldine”.

II.2. Në datën 14.08.2018 operatori ekonomik “Snajper Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit.

II.3. Nëpërmjet shkresës nr.924/1 prot., datë 20.08.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.4. Në datën 28.08.2018 operatori ekonomik “Snajper Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj

Arsyeton

III.1. Në datën 09.08.2018 është publikuar në SPE procedura e prokurimit “Marrëveshje kuadër”, me Nr.REF-82421-08-08-2018, me objekt: *“Sherbimi me roje private SH.P.S.F”*, me fond limit limit 8.163.448,96 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.09.2018 nga autoriteti kontraktor S.U.O.GJ “Mbreteresha Geraldine”.

III.2. Sikurse pohon dhe vetë ankimuesi, në datën 14.08.2018 operatori ekonomik “Snajper Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit.

III.3. Nëpërmjet shkresës nr.924/1 prot., datë 20.08.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

III.4. Në datën 28.08.2018 operatori ekonomik “Snajper Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

III.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 1.1 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.6. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik “Snajper Security” sh.p.k është paraqitur në autoritetin kontraktor në datën 14.08.2018, fakt ky i pohuar edhe nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 924/1 prot., datë 20.08.2018 me objekt *“Përgjigje ankesës me objekt: “Shërbimi me roje private SH.P.S.F të operatorit ekonomik “Snajper Security” sh.p.k, me nr.924 prot., datë 14.08.2018”* drejtuar operatorit ekonomik ankimues. Autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit në datën 20.08.2018 dhe në datën 29.08.2018 është protokolluar ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik nga shoqëria “Snajper Security” sh.p.k.

III.7. KPP vlerëson të ndalet në sqarimin e momentit të analizimit të situatës përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues.

Referuar datës së paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor nga ana e ankimuesit (14.08.2018), fakti i pranuar nga ky i fundit, autoriteti kontraktor brenda 3 ditëve nga paraqitja e ankesës pranë tij duhet të kthente përgjigje, pra referuar datës 14.08.2018 kur është depozituar ankesa pranë autoritetit kontraktor, ky i fundit duhet të shqyrtonte ankesën dhe të nxirrte vendimin brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Nëse autoriteti kontraktor nuk e shqyrton ankesën brenda këtij afati, ankimuesi mund të paraqesë ankesë me shkrim pranë KPP, brenda 10 ditëve duke nisur nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit kohor të shqyrtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

Referuar këtyre përcaktimeve, nisur nga data 14.08.2018, datë e pranuar edhe nga operatori ekonomik për paraqitjen e ankesës pranë autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit ka dështuar ta paraqesë ankesën në lidhje me modifikimin e dokumentave të tenderit, në KPP brenda afateve ligjore të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik, pasi, për faj të vetë ankimuesit nuk është paraqitur ankimi në shkallët e tjera brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Mos respektimi i afatit të kthimit të përgjigjes nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimues, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 të LPP-së.

Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë këtij të fundit më datë 29.08.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë.

Public Health Sector

III.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë K.P.P. nuk ka respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, çka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

III.9. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi,

juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Snajper Security” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*”, me Nr.REF-82421-08-08-2018, me objekt: “*Sherbimi me roje private SH.P.S.F*”, me fond limit 8.163.448,96 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.09.2018 nga autoriteti kontraktor S.U.O.GJ “Mbretresha Geraldine”.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1444 Protokoli;

Datë 29.08.2018



Public Health Sector

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha